



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA

REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT

OPŠTINA LIPLJAN

MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	11.06.2026
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji Maj 01.05.2026-31.05.2026

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E RAPORTIMIT

Gjatë muajit Maj DKA ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme brenda kompetencave të veta.

PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE

Më datë **14.05.2026** ka përfunduar viti mësimor për nxënësit e klasave të XII-dymbëdhjetë.

Është bërë furnizimi me projektor dhe pajisje tjera përcjellëse në Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime, Shfmu “Kadri Beba” në Ribar i Madh dhe Shfmu “Vëllezërit Frashëri” në Lipjan dhe me mjete higjienike të gjitha shkollat.

Komuna e Lipjanit, qdo vit bënë ndarjen e bursave për student, pothuajse qdo vit numri është rritur me qëllim që tu mundësohet përfshirja e sa më shumë studentëve të Komunës sonë. Këtë vit është bërë ekzekutimi i pagesave për bursa për **404 studentë** nga Komuna e Lipjanit e cila ka pasur vlerën **202,000 euro**.

MASHT-i edhe këtë vit ka bërë organizimin e Olimpiadës së II-të e Përbashkët në lëndën e gjuhës shqipe, klasa e nëntë, në të cilën garë kanë marrë pjesë edhe nxënëset nga Komuna e Lipjanit.

Përgatitja teknike për mbajtjen e testeve: Testin e arritshmërisë dhe maturës për vitin shkollor 2026/2027.

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) do të realizoj projektin në fushën e të drejtave të fëmijës, ku pjesë e këtij projekti do të jenë këto shkolla:

- Shfmu “Zenel Hajdini” në Gadime
- Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan
- Shfmu “Dy Dëshmorët” në Dobrajë e Madhe
- Shfmu “Haradin Bajrami” në Magure

Në kuadër të ditës botërore kundër duhanit **31.05.2026** Ministria e Shëndetësisë dhe Instituti Kombëtar i shëndetësisë Publike kanë realizuar garën kombëtare “Të rinjtë për një Kosovë pa duhan” ku në mesin e të gjitha punimeve të punuara nga shkollat Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan ka zënë vendin e dytë në nivel vendi.

Si qdo vit edhe këtë vit është mbajtur edicioni III të Kuizit të Diturisë 2026.

Ky aktivitet, i cili tashmë është kthyer në traditë, organizohet nga SHFMU “Ismail Luma” në Lipjan nën mbështetjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit - Lipjan. Në këtë kuiz fitues ishte shkolla Shfmu “Drita” në Rubovc.

Përgatitja dhe dërgimi i të dhënave në MASHT për planifikimin e nxënësve në klasën e 10-dhjetë për vitin shkollor **2026/2027**.

Komisioni Komunal për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta ka bërë vlerësimin pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta, konform kërkësve nga drejtorët e shkollave.

Mbajtja e ditës së shkollës në:

- Shfmu “Dy Dëshmorët” në Dobrajë e Madhe
- Shfmu “Kadri Beba” në Ribar i Madh
- Shfmu “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë
- Shfmu “Rexhep Akllapi” në Akllap
- Shfmu “Katër Dëshmorët” në Krojmir

22 nxënës nga disa shkolla të Komunës së Lipjanit shpallen fitues në garat ndërkombëtare “Kangaro dhe HIPPO” si dhe një nxënëse e klasës VI-gjashtë nga SHFMU “Emin Duraku” në Banullë ka fituar qmimin në lëndën e gjuhës angleze e cila është përzgjedhur të marrë pjesë edhe në garat jashtë vendit në Itali e cila është subvencionuar nga Komuna e Lipjanit.

Nënalokimi i mjeteve në kategorinë: Paga, Mallra dhe Komunal.

Zotimi i mjeteve mallra&shërbime, komunal dhe subvencione.

Kërkesë Drejtoratit të Prokurimit për zhvillimin e procedurës së prokurimit për:

- Furnizimin e Çerdheve dhe shkollave me inventar
- Shitjen e prodhimeve bimore-grurit të mbjellura në parcelat tokësore (sipërfaqet) që janë në pronësi të shkollës “Adem Gllavica” në Lipjan.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:

- Formular për ndryshime-kthimi nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit, shtimi i përvojës,
- Formular për largim-skadim kontrate, pensionimi,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme-ndërrimi i xhirollogarisë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).

STATISTIKAT

Nuk kemi statistika për këtë muaj

TAKIME TË NDRYSHME

Janë realizuar takime të rregullta me drejtorët e shkollave

Me psikoget e shkollave

Me përfaqësuesit e ekipit për nxënësit me nevoja të veqanta

REKOMANDIMET

- Angazhimi i drejtorëve të shkollave për një organizim sa më të mirë të procesit edukativo-arsimor dhe
- Angazhimi i psikologeve në trajtimin e temave me rëndësi për nxënësit në të gjitha shkollat e Komunës.

ÇËSHTJE TJERA

Të gjitha punët e realizuara janë cekur në raport dhe nuk ka ndonjë çështje tjetër për të elaboruar. DKA do të punoj vazhdimisht për krijimin e kushteve sa më të mira në të gjitha shkollat e Komunës sonë, duke menduar gjithmonë më të mirën për të gjithë nxënësit.